



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR BARAZI GJINORE**

Në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neneve 47 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë,

T H Ë R R A S

Mbledhjen e IV (katërt), **Komitetit për Barazi Gjinore**, Mandati i VII-të i Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **27 dhjetor 2022**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, kati I - objekti i Komunës, në orën **11:00**, me këtë:

Rend dite

1. Procesverbalë nga mbledhja e mbajtur më 29 nëntor 2022
2. Të gjeturat nga vizita e anëtarëve të Komitetit në zonat rurale të qytetit si dhe nxjerrja e rekomandimeve
3. Fillimi i hartimit të planit të punës së Komitetit për vitin 2023
4. Të ndryshme

Nr.prot.01-060/03-0102488 /22
Podujevë,
16 dhjetor 2022

Kryesuesi i Komitetit
Ragip Fetahu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR BARAZI GJINORE

Procesverbal nga mbledhja e III- (tretë - mandati VII i Kuvendit), i Komitetit për Barazi Gjinore, e mbajtur më 29 nëntor 2022

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës dhe filloi në orën 10:40.

Mbledhjen e hapi z.Ragip Fetahu, në cilësinë e Kryesuesit të Komitetit.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: z.Ragip Fetahu, znj. Drita Pajaziti, znj. Edona Shabani, z. Fahri Hasani, znj. Gentiana Gashi si dhe znj. Naime Podvorica nga zyra komunale për barazi gjinore.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për vazhdimin e mbledhjes së Komitetit.

Rendi i ditës

z. Ragip Fetahu, si kryesues i komitetit për BGJ hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i falenderuar për pjesëmarrje. Me këtë rast kërkoi që të votohet për rendin e ditës nga të anëtarët e komisionit.

Rendi i paraparë i ditës u mbështet njëzëri nga të pranishmit.

1. Së pari u hodh në votim pika e parë e rendit të ditës- Procesverbali nga mbledhja e kaluar. *Pas votimit, u konstatua njëzëri (me 5 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent) miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.*

2. Prezentimi i të dhënave nga anketimi i nxënësve të Shkollave të Mesme të Larta në Komunën e Podujevës, lidhur me barazinë gjinore nëpër shkolla

z.Ragip Fetahu, theksoi, së pari ne kemi hartuar një anketë me gjashtë pyetje të hapura dhe të mbyllura. Metoda shkencore e përdorur nga ne ishte ajo sasiore. Janë shtypur 100 anketa dhe realizimi i anketimit bërë në tri Shkollat e Mesme të Larta të Komunës tonë, pra në Gjimnaz, Ekonomik si dhe në Shkollën e Mesme Ekonomike. Pyetësorët janë ndarë në mënyrë proporcionale për secilën shkollë nga 33. Mostra ishte e rastit dhe janë anketuar nxënësit e klasës së XII në të tri shkollat. Vlen të theksohet se anketimi është realizuar më 08.11.2022.

Është interesant të theksohet fakti se kemi vërejtur një disproporcion gjinorë në klasat ku ne kemi realizuar anketimin. P. Sh. Në ekonomik në klasë, ku ne ishim, ishin gjithësejt 27 vajza dhe vetëm dy djem.

Nga ana tjetër, në Shkollën e Mesme Teknike nga 25 nxënës prezent në klasë, vetëm 2 nga ta ishin femra. Kurse, në Gjimnaz dallimi gjinor ishte më i baraspeshuar.

Do të rekomandoja që DKA- ja të rishqyrtojë politikat

arsimore në mënyrë që ta bëjë Shkollën e Mesme Teknike më atraktive për vajzat me programe të ndryshme informuese për shkak të dallimit të madhë gjinorë që ekziston në atë shkollë.

E rëndësishme është fakti se pas analizimit të të dhënave nga tereni ka rezultuar se në hulumtim kanë marrë pjesë njëqind nxënës, ku nga ta 54 % ishin djem, kurse 46 % ishin femra.

Vlen të theksohet fakti nga 33 nxënës të anketuar në Shkollën e Mesme Teknike Fan S. Noli 87% prej tyre ishin djem, kurse vetëm 13% e të anketuarve ishin vajza.

Më lejoni të ndajë me ju gjetjet nga anketimi;

- Në pyetjen tonë se sa herë jeni ndier i/e diskriminuar, të anketuarit janë përgjigjur si vijon; 2 % e nxënësve janë ndier shpesh herë të diskriminuar. Vlen të theksohet fakti se pjesa më e madhe e nxënësve (53%), kanë deklaruar se nuk janë ndier asnjëherë të diskriminuar.

Por, megjithatë është vërtetuar hipoteza jonë se në shkollat e mesme ka diskriminim gjinor.

- Arsyet e diskriminimit në raport nxënës-nxënës si dhe nxënës-profesor janë: për 36 % e nxënësve arsye e diskriminimit llogaritet të jetë vendbanimi, pra prejardhja e tyre nga fshati, 25% e nxënësve të anketar janë ndier të diskriminuar për shkak se prindërit e tyre apo anëtarët e tjerë të familjes nuk kanë nivel të lart të shkollimit, 14% e nxënësve janë shprehur se janë ndier të diskriminuar për arsye gjinore.

- Nga ana tjetër, 7 % e nxënësve të anketuar janë shprehur se ndihen të diskriminuar për arsye të shprehjes së besimit të tyre fetar.
Kurse 2% e nxënësve ndihen jo të barabart në shkollë për shkak se shokët e tyre bëjnë shaka të tepruar me ta për stilin e veshjes, dukjen etj.
- E gjetur tjetër është edhe fakti se ka favorizime në shkollat e mesme mbi baza gjinore. Këtë e kanë pohuar 43 % e nxënësve të anketuar. Pjesa tjetër e nxënësve nuk e dinë ose nuk kanë njohuri të ketë ndodhur diçka e tillë.
- Më të favorizuara në shkolla dalin të jenë vajzat me 64 %, kurse për 36 % janë djemt ata të cilët favorizohen më tepër.

Më tutje z. Fetahu hapi debatin dhe ju kërkoi të pranishmëve që së bashku të nxjerrim rekomandimet për ekzekutivin se cka duhet të bëjë në mënyrë që të trajtohet problemi i diskriminimit nëpër shkollat e Podujevës.

Znj. Naime Podvorica, (nga Zyra për Barazi Gjinore), theksoi, se ky anketim është një testim i mirë për problematikën e diskriminimit në shkolla në komunën tonë. Është mirë që përpara kemi një pasqyrë shumë të mirë për gjendjen dhe duke u bazuar në këtë duhet të ndërmarim ndonjë fushatë sensibilizuese kundër këtij problemi. Këtë, me qëllim që ta ndërrojmë gjendjen për mirë. Nuk është lehtë me e eliminu krejt këtë problem, por në do të punojmë që të paktën ta reduktojmë, në mënyrë që anjë nxënës të mos ndihet i diskriminuar për shkak të dukjes apo të veshjes së tij. Në këtë mënyrë me u konsideru të gjithë të barabart dhe me u mësu që me e pranuar secilin në atë gjendje apo form si ai apo ajo është.

Znj. Drita Paraziti, theksoi, se diskriminimi mbi të gjitha gjinor është më shqetësues se sa që ka dal në rezultate, sepse për mendimin tim nxënësit nuk e kanë treguar situatën reale si është në të vërtetë.

Gjithashtu, është shumë shqetësuese së në qytetin tonë e kemi këtë mendësi të përgjithshme. Është mirë të bëhen fushata vëdiqësuese, por duhet menduar mënyra efektive.

Për ta prandaluar diskriminimin mbi baza të prejardhjes, fshat apo qytet, është mirë që të rikthehet uniforma shkollore.

Znj. Edona Shabani, theksoi, e vërtet është fakti se uniforma i zhduk pabarazitë sociale në pamje të nxënësve. Unë kur isha në shkollën e mesme, mbanim uniform në shkollë dhe si rezultat i saj veshja nuk ishte problem në shkollë. Edhe unë jam e mendimit se uniforma e nxënësve duhet të rikthehet nga DKA- ja, në shkolla.

z.Fahri Hasani, theksoi, se psikologët e shkollave kanë rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Unë po ju jap një shembull për rolin e psikologut në shkollë. Ai përmes këshillave pozitive ka ndikuar pozitivisht te një nxënës që unë e njoh. Madje, ai (psikologu) ka dhënë lavdata në fund për nxënësin se çfarë nxënësi i mirë është bërë.

Znj. Drita Paraziti, theksoi, unë rekomandoj që të mbahen ligjerata vëdiësuese nga profesorët e të gjitha lëndëve sa ma shpesh në për shkolla për fenomene negative përfshirë këtu edhe diskriminimin. E informatat se cka nevojitet për me i parandalu është mirë që t'i bëjmë ne si komitet, zyra për barazi gjinore si dhe DKA-ja. Në kuadër të ligjeratave për diskriminimin mund të përfshihen edhe dhuna nëpër shkolla, bullizmi, pabarazia gjinore dhe jo vetëm.

z.Ragip Fetahu, theksoi, duhet menduar edhe këtë që ekzekutivi të bëjë përpjekje që investimet t'i fokusoj si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, sepse politika të tilla kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në këtë mënyrë ndihmohet edhe në largimin e pabarazive mbi baza vendbanimi.

4. Të ndryshme- në këtë pikë nuk kishte të interesuar për të diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11;55

Procesverbalin e mbajti

Ragip Fetahu

Podujevë, 29 nëntor 2022

Kryesues i mbledhjes

Ragip Fetahu